

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6369
E premte, 23 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Rritet numri i rasteve të reja me Covid në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË MUAJ E GJYSMË PASI KISHTE NËNSHKRUAR VENDIMIN PËR TAKSËN PREJ PESË EUROSH PËR VETURAT E REGJISTRUARA, ZËVENDËSMINISTRI HYSEN DURMISHI KA PEZULLUAR KËTË VENDIM

DORËZOHET QEVERIA, PEZULLON VENDIMIN PËR TAKSËN PREJ 5 EUROSH PËR VETURAT



Qeveria e Kosovës është dorëzuar përballë presionit të opinionit publik për çështjen e tiktës ngjitëse për veturat e regjistruara. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka treguar arsyet që kanë çuar në pezullimin e taksës prej pesë eurosh. Partitë opozitare kanë kërkuar anulimin e këtij vendimi dhe dorëhe-

qjen e zëvendësministrit Hysen Durmishi i cili e kishte nënshkruar këtë vendim. Gjithashtu, partitë opozitare kanë ftuar organet e drejtësisë që ta hetojnë gjithë procesin në fjalë

KMDLNJ: MOSPËRKTHIMI I MATERIALEVE NGA SPECIALJA PAMUNDËSON MBROJTJEN EFEKTIVE TË TË AKUZUARVE



KUVENDI E MIRATON MARRËVESHJEN IPA PËR VITIN 2020, PËRKRAHET EDHE NGA OPOZITA

FAQE 7

NUK KA BURG PËR ATA QË NUK E DEKLAROJNË PASURINË

F. 8

MIRATOHET NË PARIM PROJEKTLIGJI PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



PDK-ja FTON DEBAT PARLAMENTAR PËR 100 DITËT E QEVERISË KURTI

F. 3

VOUÇIQ: NËSE DIKUSH E NJEH KOSOVËN, NE E NISIM FUSHATËN E ÇNJOHJEVE

F. 2

MBAHET PUNËTORIA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NËPËR KOMUNA

F. 6



EKONOMI



Vuçiqi: Nëse dikush e njeh Kosovën, ne e nisim fushatën e çnjohjeve

PRISHTINË, 22 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha të enjten se "nëse dikush merr vendim për njohjen e Kosovës shtet të pavarur", Serbia "do ta nisë menjëherë fushatën për tërheqjen e njohjeve të Kosovës". "Kam shumë respekt për presidentin turk [Rexhep Tajip] Erdogan dhe dua marrëdhëniet më të mira me Turqinë, por ne kemi vendin tonë dhe interesat tona dhe do të sillemi në përputhje me to", ka deklaruar Vuçiq. Ai i bëri këto komente pas deklaratave të Erdoganit këtë javë, se ai do të punojë me presidentin amerikan Joe Biden për të rritur numrin e shteteve që njohin Kosovën.

Erdogani ka theksuar se do ta ngrrejë këtë çështje gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara këtë vjeshtë.

Vuçiqi tha një ditë më herët se do të bisedojë me Erdoganin rreth Kosovës.

Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008.

Sipas listës së publikuar në uebfaqen e Ministrisë së Jashtme të Kosovës, janë 117 vende që e njohin atë. Serbia qysh në vitin 2017 thuhet se ka bërë fushatë për tërheqjen e njohjeve të shtetit të Kosovës dhe, për pasojë, disa vende thuhet se i kanë ngrirë raportet e bashkëpunimit me Kosovën. Në shtator të vitit të kaluar



Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje në Uashington, në bazë të së cilës Serbia është dashur ta pezullojë

fushatën për çnjohjen e Kosovës, ndërsa Kosova është dashur të respektojë një moratorium njëvjeçar, për të mos aplikuar

për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Afati i këtij moratoriumi skadon në fillim të shtatorit.

Kina refuzon planin e OBSH-së për hetime të reja të virusit



PEKIN, 22 KORRIK - Kina ka refuzuar një plan të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për hetime të reja mbi origjinën e koronavirusit.

Ditë më parë OBSH-ja propozoi një fazë të dytë të hetimeve që do të përfshinin auditim të laboratorëve dhe tregjeve në Vuhan, qytetin ku koronavirusi u shfaq për herë të parë. "Ne nuk do të pranojmë një plan të tillë të hetimit të origjinës, pasi ai, në disa aspekte, sfidon shkencën", u tha gazetarëve Zeng Yixin, zëvendësministër i

Komisionit Kombëtar Shëndetësor të Kinës.

OBSH-ja ka përfunduar fazën e parë të hetimeve në Vuhan në muajin shkurt.

Atëbotë është konstatuar se nuk ka shumë gjasa që koronavirusi të ketë dalë nga laboratorit në Vuhan dhe se ai mund ta ketë origjinën nga lakuriqët.

Disa vende dhe shkencëtarë nuk kanë qenë të kënaqur dhe kanë kërkuar hetime të tjera. Zeng ka kërkuar nga OBSH-ja që t'i zgjerojë përpjekjet e kërkimit të origjinës së

koronavirusit përtej Kinës, në vende të tjera.

OBSH-ja e ka shpallur pandeminë koronavirusin në mars të vitit 2020. Deri më tash koronavirusi ka prekur mbi 191.9 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 4.1 milionë kanë vdekur. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka kërkuar nga agjencitë amerikane të inteligjencës në muajin maj, që brenda tre muajsh t'i raportojnë nëse koronavirusi e ka burimin te kafshët apo nga ndonjë aksident laboratorik.

Merkeli kërkon veprime të shpejta kundër ndryshimeve klimatike

BERLIN, 22 KORRIK - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka theksuar nevojën për ta përshpejtuar luftën kundër ndryshimeve klimatike, pasi numri i viktimave nga përmbytjet shkatërruese në Gjermani arriti të enjten në 177. Merkeli ka thënë se Gjermania dhe vendet e tjera "nuk kanë bërë aq sa duhet" për ta kufizuar ngrohjen globale në 1.5 gradë celsius, një qëllim ky i vendosur me Marrëveshjen e

Parisit për Klimën. "Nuk duhet të pretendojmë se nuk kemi bërë asgjë, por është e vërtetë që nuk është bërë aq sa duhet për të qëndruar nën 2 gradë dhe sa më afër 1.5-shit. Kjo nuk është e vërtetë vetëm për Gjermaninë, por për shumë vende në të gjithë botën, prandaj duhet ta rritim ritmin", u tha Merkel gazetarëve.

Kabineti i saj miratoi të mërkurën një paketë emergjente në vlerë prej 400

milionë eurosh për t'i ndihmuar rajonet e prekura. "E kemi bërë të qartë se kjo shumë do të rritet nëse nuk është e mjaftueshme", ka deklaruar Merkel.

Dy landet më të goditura nga përmbytjet e javës së kaluar janë: Rajnland Falc dhe Nordrajn Vesthalen. Numri i viktimave rritet ende, pasi ekipet e shpëtimit vazhdojnë të gjejnë trupa që janë zhdukur në përmbytje.



Biden: Pandemia vazhdon të pavaksinuarit

UASHINGTON, 22 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, u bëri thirrje amerikanëve që të vaksinohen, duke thënë se

koronavirusi është kryesisht pandemi në mesin e atyre që nuk janë vaksinuar. "Nëse jeni të vaksinuar, nuk do të shtroheni në spital, nuk do të

jeni në njësi të kujdesit intensiv dhe nuk do të vdisni. Është vërtet e thjeshtë. Ne kemi pandemi tek ata që nuk janë vaksinuar", ka deklaruar

Biden në një ngjarje në Ohajo. Presidenti shtoi se vaksinimi i fëmijëve nën 12 vjeç ka të ngjarë të miratohet në javët e ardhshme.



Arrestohen katër persona për 'falsifikim të parasë' dhe 'mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve'

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 KORRIK - Policia e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, e mbështetur nga NJSO-ja dhe Krim Teknika e DPP-së, të enjten ka kryer kontrollin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të personave të dyshuar: H. K. (1988), S. K. (1970), V. K. (2001) dhe V. K. (2000), nën dyshimin për kryerjen e veprave penale "Falsifikim i parasë" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

Këta të dyshuar që në janar të këtij viti, në bashkëveprim, kanë vënë në qarkullim shumën prej 10 000 dollarëve amerikanë në qytetin e Pejës dhe Prizrenit, ku është konstatuar se paratë ishin të falsifikuara.

Me qëllim të hetimit dhe gjetjes së dëshmitëve shtesë janë aplikuar masa të fshehta të hetimit prej nga është arritur të sigurohen dëshmi relevante që do të

përdoren në procedurë të mëtejme.

Gjatë kontrollit është gjetur edhe një armë 'AK-47', një karikator, katërmbëdhjetë fishekë të cal. 7.62, në pronësi të të dyshuarit S. K. ndaj të cilit është ngritur kallëzim penal për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" e sanksionuar nga neni 366 i KPRK-së.

Nga të dyshuarit janë sekuestruar si provë materiale dy 'Iphone' 6S dhe një 'Iphone' xs max.

Të dyshuarve, pas intervistimit, me vendim të prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës u është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orëve. Policia e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe autorizimeve të saj ligjore, në funksion të garantimit të një mjedisi të qetë e të sigurt për të gjithë si dhe sjelljen para organeve të drejtësisë të personave të përfshirë në aktivitetet kriminale.



PDK-ja fton debat parlamentar për 100 ditët e qeverisë Kurti

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, në një konferencë për media mbajtur të enjten, ka thënë se qeveria Kurti është qeveria e parë në historinë e Republikës së Kosovës që nuk e sjell për debat parlamentar raportin e 100-ditëshit.

Tahiri ka njoftuar se PDK-ja ka iniciuar procedurat për organizimin e këtij debati parlamentar javën e ardhshme. "Raporti i 100-ditëshit është jashtëzakonisht i rëndësishëm për faktin që në këto 100 ditë vendosen bazat e qeverisjes katërvjeçare. Në këto 100 ditë qeveria na tregon se cila do të jetë agjenda e saj në katër vjetët e

ardhshëm, cilat iniciativa fillojnë, çka do të zhvillohet gjatë katër vjetëve. Ju jeni dëshmitarë edhe të sjelljes me vonesë të programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka thënë ai.

Tahiri ka theksuar që është hera e parë në traditën parlamentare të Kosovës që një parti opozitare fton debat parlamentar për 100 ditët e qeverisë e jo qeveria siç shkon rëndom në çdo shtet të botës. "Ne kemi pritur deri sot sepse kemi besuar që është një vonesë, por prapëseprapë qeveria do të procedojë këtë raport të 100-ditëshit. Por, kur e pamë që këta po përpiqen të shmangen nga çfarëdo debati, ne tashmë kemi proceduar në administratën e kuvendit që në javën e ardhshme të vendoset debat parlamentar për 100 ditët e kësaj qeverie", ka thënë Tahiri.

Rritet numri i rasteve të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Njëzet e tetë persona kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 të enjten në Kosovë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, këto rezultate dolën nga 2 577 mostra të testuara.

Në 25 orët e fundit 18 pacientë

janë shëruar nga Covidi, ndërkaq raste aktive mbeten 114, ndërsa nuk u shënua asnjë rast i vdekjes nga Covid-19.

Që nga fillimi i pandemisë, në mars të vitit të kaluar, Kosova ka regjistruar gjithsej 107 954 raste me Covid-19. Prej këtyre, 2 265 pacientë kanë vdekur dhe 105 575 janë shëruar.

Aktualisht në Kosovë është duke u zhvilluar vaksinimi masiv i qytetarëve, që do të thotë se të gjithë personat mbi 18 vjeç mund të regjistrohen për t'u imunizuar. Deri të martën në Kosovë janë dhënë mbi 333 705 vaksina.

Qeveria e Kosovës ka thënë se ka prioritet vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve deri në fund të vitit.





NJË MUAJ E GJYSMË PASI KISHTE NËNSHKRUAR VENDIMIN PËR TAKSËN PREJ PESË EUROSH PËR VETURAT E REGJISTRUARA, ZËVENDËSMINISTRI HYSEN DURMISHI KA PEZULLUAR KËTË VENDIM

Dorëzohet qeveria, pezullon vendimin për taksën prej 5 eurosh për veturat

Qeveria e Kosovës është dorëzuar përballë presionit të opinionit publik për çështjen e tiktës ngjitëse për veturat e regjistruara. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka treguar arsyet që kanë çuar në pezullimin e taksës prej pesë eurosh. Partitë opozitare kanë kërkuar anulimin e këtij vendimi dhe dorëheqjen e zëvendësministrit Hysen Durmishi i cili e kishte nënshkruar këtë vendim. Gjithashtu, partitë opozitare kanë ftuar organet e drejtësisë që ta hetojnë gjithë procesin në fjalë

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 22 korrik - Pas presionit të madh të publikut, Qeveria e Kosovës ka pezulluar vendimin për taksën prej pesë eurosh për tiktat ngjitëse e cila do të dëshmonte se një veturë është e regjistruar.

Në seancën parlamentare të së enjtes, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka konfirmuar lajmin për pezullimin e kësaj takse, duke thënë se do të shqyrtohet i gjithë procesi deri te ky vendim. "Ju njoftoj se për çështjen e taksës

pesë euro për tiktat ngjitëse sapo është marrë vendim që të pezullohet si vendim dhe do ta shqyrtojmë në hollësi mënyrën se si ka ardhur deri te ky vendim. Pra, prej interpretimeve të ndryshme ligjore, duke përfshirë edhe interpretimet dhe trajtimet nga Auditori e të gjitha me radhë, deri te momenti i nënshkrimit. Pra, ky vendim është pezulluar. Diçka çka mund t'ju siguroj është se qytetarët nuk do t'i paguajnë 5 euro", ka deklaruar Aliu.

Më pas vendimin e ka sqaruar edhe zëvendësi i Aliut, Hysen Durmishi, i cili e ka marrë vendimin për ta nënshkruar dhe

anuluar këtë kontratë. "Sot kam marrë vendim që ta pezulloj marrëveshjen për tiktat ngjitëse deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë çështje. Pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe vëmendjes së madhe të opinionit publik kam gjetur dokumente e raporte që janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Unë jam bazuar në dy dokumente të rëndësishme para se të nënshkruaja marrëveshjen e ato janë: raporti i auditorit të brendshëm të ministrisë dhe opinionin e zyrës ligjore i kryeministrit të datës 20.01.2020, i harmonizuar me zyrat ligjore të MI, MAP dhe

MD", ka shkruar Durmishi në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, vendimin përfundimtar do ta marrë pas rishikimit të funksionimit të sistemeve dhe standardeve të kontroleve të brendshme të ministrisë.

Opozita kërkon anulim të taksës dhe hetim të rastit

Pezullimi i vendimit për taksën pesë euro për veturat ka nxitur reagimin e partive opozitare. Përfaqësuesit e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së e kanë kundërshtuar vendimin për pezullimin e këtij vendimi, duke thënë se një gjë e tillë është pamjaftueshme. Ata kanë kërkuar anulim dhe hetim të kontratës.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se kjo taksë ka qenë e kundërligjshme, prandaj duhet të anulohet. "Ne nuk pajtohemi vetëm me pezullimin e taksës. Ajo duhet të anulohet sepse është nënshkruar kundërligjshëm. Ne

ia kemi zënë dorën qeverisë në xhep të qytetarit po, fatmirësisht, paratë nuk kanë arritur t'i marrin", ka thënë Tahiri në seancën plenare të së enjtes. Lidhja Demokratike e Kosovës e ka ftuar prokurorinë që ta hetojë gjithë procesin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Në reagimin e LDK-së është thënë se anulimi i kontratës, pas nënshkrimit, tregon se sa e papërgatitur dhe joprofesioniste është kjo qeveri. "Qeveria e praktikantëve! Anulimi i pagesës prej pesë eurove, pjesë e një procesi të dyshimtë, është përfundimi i vetëm logjik. Gjithsesi, nënshkrimi i kontratës fillimisht e më pas anulimi i saj pas presionit publik, me pretekstin që duhet bërë analizë, tregon se sa të papërgatitur e joprofionistë janë anëtarët e qeverisë së praktikantëve. Përgjegjësit duhet të mbajnë përgjegjësi. Mbi të gjitha, Lidhja Demokratike e Kosovës fton prokurorinë që të hetojë gjithë procesin në fjalë dhe dëmet

eventuale financiare që mund të krijohen nga një aferë e aventurë e tillë”, është thënë në reagimin e LDK-së.

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar nga prokuroria t'i nisë hetimet për këtë marrëveshje. “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se, edhe pse taksa është anuluar, prokuroria duhet t'i bëjë hetimet për këtë marrëveshje të dëmshme, ku një kompanie me tre punëtorë u tentua t'i jepeshin miliona euro nga xhepat e qytetarëve të Kosovës”, është thënë në reagimin e AAK-së. Sipas kësaj partie, ky rast ka treguar se arroganca e numrave nuk kryen punë përballë një reagimi të fortë opozitar dhe të shoqërisë

civile. “Pezullimi i marrëveshjes për tiketa ngjitëse, me të cilën ngarkoheshin qytetarët që kanë automjete, jo në dobi të buxhetit, por të një kompanie private, është tregues i qartë se arroganca e numrave nuk kryen punë përballë një reagimi të fortë opozitar dhe të shoqërisë civile. Qeveria e mashtrimit, megjithëse mobilizoi sejmënët për ta arsytuar vendimin e dëmshëm, nuk arriti të qëndrojë para presionit të drejtë kundër kësaj padrejtësie që dëshironte t'ia servonte qytetarëve të vendit. AAK-ja dhe kryetari Haradinaj kanë qenë shumë të zëshëm për këtë vendim, por edhe për shumë vendime të tjera të padrejta të kësaj qeverie. Dështimet e

qeverisë shihen gjithandëj e zhgënjimi është në rritje”, është thënë në reagimin e AAK-së.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe kundërshtuesi më i madh i kësaj takse, kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se tani është konfirmuar se kjo parti dhe të gjithë ata që e kundërshtuan këtë marrëveshje kishin të drejtë. “Marrëveshja u pezullua, zvatja u konfirmua. U konfirmua që ne dhe të gjithë ata që e kundërshtuan këtë marrëveshje kishim të drejtë. U konfirmua që dhuna e përdorur ndaj nesh nuk ishte e rastësishme, por e qëllimshme, sepse pushtetit të Kurtit i dhem shumë kur e sulmon aty ku duhet, kur ia zbulon

zvatjen e buxhetit. U konfirmua që kur ke të drejtë, pavarësisht a je ‘i vogël’ apo i madh, në fund triumfon”, ka shkruar ai.

Ai ka kërkuar dorëheqjen e zëvendësministrit Hysen Durmishi i cili e ka nënshkruar këtë marrëveshje. “Nënshkruesi i kësaj marrëveshjeje zvatëse, zëvendësministri Hysen Durmishi dhe gjithë të tjerët të përfshirë në këtë marrëveshje, duhet të dorëhiqen menjëherë. Pavarësisht prej pezullimit të marrëveshjes, kallëzimi penal i PSD-së duhet të shqyrtohet me prioritet dhe nënshkruesi i saj ta marrë dënimin konform ligjeve të vendit. Faleminderit shumë të gjithëve për mbështetjen në rezistencën tonë kundër kësaj

marrëveshjeje! Kjo është vetëm fitorja e parë kundër këtij pushteti populist”, ka shkruar Molliqaj.

Marrëveshja për tiketa ngjitëse për automjetet të cilat regjistrohen mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kompaninë private ishte nënshkruar më 8 qershor 2021. Kjo marrëveshje ka hasur në kundërshtime të mëdha nga qytetarët dhe partitë opozitare. Për këtë çështje, Partia Socialdemokrate ka ngritur edhe kallëzim penal kundër zëvendësministrit Hysen Durmishi për, siç është thënë, keqpërdorim të pozitës zyrtare për nënshkrimin e marrëveshjes.

KMDLNj: Mospërkthimi i materialeve nga Specialja pamundëson mbrojtjen efektive të të akuzuarve



PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka thënë të enjten se është e drejtë elementare e personave të privuar nga liria që t'i kenë materialet e përkthyer në gjuhën e tyre. “Së fundi, një ndër të akuzuarit nga Gjykata Speciale, z. Kadri Veseli, kërkoi që të gjitha materialet që kanë të bëjnë me rastin e tij të përkthehen në gjuhën shqipe në mënyrë që ta përgatitë mbrojtjen e që deri më tani kjo e drejtë elementare e njeriut në përgjithësi dhe e drejtë e personave të privuar nga liria, në veçanti vetëm pjesërisht ishte përmbushur ose ishte përmbushur me vonesë të madhe e që ka ndikuar në cilësinë e përgatitjes së mbrojtjes.

KMDLNj edhe më parë ka reaguar për faktin se, edhe në vendimet për konfirmim të aktakuzës, përkthimi në gjuhën shqipe ka qenë jo i plotë dhe ishte bërë me vonesë. Gjykata Speciale pati dalë me një sqarim se materialet gjyqësore po përkthehen, mirëpo duket se këtë çështje e ka konsideruar dhe po e konsideron si çështje të rëndësishme dytësore dhe në këtë mënyrë po i shkel të drejtat e njeriut për persona të privuar nga liria e që mbrohen me ligjet e Kosovës (thuhet se kjo gjykatë është e Kosovës) dhe me ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e që janë integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka theksuar se kjo çështje ndërlikohet dhe banalizohet skajshmërisht për faktin se Gjykata Speciale deklaroi se të burgosurit në aktakuzë e sigurisht edhe të paraburgosurit duhet t'i drejtohen kësaj gjykate që materialet të përkthehen në gjuhën amtare apo në gjuhën që e kuptojnë. “Nëse Gjykata Speciale është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, dhe ashtu deklarohet gjithmonë kur ka interes, duhet ta ketë të qartë se gjuhë zyrtare të Kosovës janë gjuha shqipe, serbe dhe të komuniteteve të tjera në rast se i plotësojnë kushtet e parapara për Ligjin e Gjuhëve që e rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë. Është kundër të drejtave

të njeriut që përkthimi gjatë seancës të jetë në gjuhën shqipe, kurse materialet që duhen për seancë nuk u dorëzohen të akuzuarve paraprakisht në gjuhën shqipe. Madje as vendimi për vazhdimin e paraburgimit nuk u dorëzohet në kohë palëve në gjuhën shqipe sikur as kundërshtimi i avokatëve mbrojtës nuk u dorëzohet me kohë të akuzuarve. Sipas Rregullores së Gjykatës Speciale, gjykatësi i procedurës e cakton gjuhën që përdoret e që është gjuha angleze”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj shton se me këtë diskriminim flagrant që u bëhet të akuzuarve me mospërkthim me kohë të të gjithë materialit në gjuhën shqipe, përveçse shkelet

Ligji për Gjuhë i Republikës së Kosovës, Gjykata Speciale e pamundëson mbrojtjen efektive të të akuzuarve e cila nuk mund të bëhet pa bashkëpunim i akuzuar-avokat, nuk siguron një proces të drejtë gjyqësor dhe nuk trajton njëjtë palët në procedurë. “Sipas ligjeve të Kosovës, të gjitha materialet fillimisht përkthehen në gjuhën shqipe, serbe dhe të komuniteteve të tjera ku përbëjnë shumicën dhe, në raste të veçanta, në gjuhën angleze. Gjykata Speciale po e bën të kundërtën, të gjithë materialet i përkthen në gjuhën angleze, në raste të veçanta në gjuhën shqipe. Për KMDLNj-në kjo është shkelje flagrante e të drejtave të njeriut, pa asnjë dyshim”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Mbahet punëtorja për menaxhimin e mbeturinave nëpër komuna

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Me qëllim të vazhimit të aktiviteteve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Asociacioni i Komunave i Kosovës ka organizuar punëtorinë dyditore me kolegjiunin e shërbimeve publike dhe zyrtarëve komunalë për menaxhimin e mbeturinave. Me këtë rast është bërë prezantimi i nisjes së projektit të kompostimit shtëpiak, ndarja e mbeturinave organike nga totali i mbeturinave që gjenerohen. Komunitet përmes këtij projekti synojnë të ulin në

vijimësi sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi, të ulin kostot e transportit dhe të trajtimin përfundimtar të mbeturinave, si dhe të kontribuojnë në këtë mënyrë për rritjen e jetëgjatësisë së përdorimit të deponisë. Njëherësh praktika e kompostimit sjell përfitime për përdoruesit për prodhimin e plehut organik të kualitetit të lartë. Po ashtu, kjo punëtori trajtoi procesin e analizës së fraksioneve të llojit të mbeturinave, ku mund të shërbejnë si indikatorë për burimet e mundshme. Ky aktivitet ndërlihet me

zbatimin e programeve dhe praktikave të mira në lidhjet e mundshme në mes të burimeve potenciale dhe vendet ose aktivitetet që gjenerojnë mbeturina të caktuara në rajonet përkatëse. Ky proces është si vijim i veprimtarisë së përbashkët me projektin e GIZ-it Shërbimet e Qëndrueshme Komunale (SMS), për ta bërë modernizimin e shërbimeve publike në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm për përmirësimin e gjendjes mjedisore.



Në Klinikën e Onkologjisë fillon puna me aparatën e ri për radioterapi



PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka vizituar të enjten Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me ç'rast, bashkë me Agreta Gashi, kryesuese e bordit drejtues të ShSKUK-së dhe Valbon Krasniqi, drejtor i ShSKUK-së, kanë përfunduar aparatën e ri për radioterapi (rrezatim) dhe hapësirën shoqëruese komode për pacientët. Ky investim nga ShSKUK-ja ka vlerë 1.5 milion euro. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë,

Arben Vitia, ka thënë se Ministria e Shëndetësisë ka në prioritet investimet në Klinikën e Onkologjisë, përfshirë aparatat mjekësore, furnizimin me barna dhe citostatikë. Po ashtu, Vitia shumë të rëndësishëm i cilësoi edukimet e vazhdueshme profesionale të stafit shëndetësor të Klinikës së Onkologjisë. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka thënë se ky investim ka qenë shumë i nevojshëm, në mënyrë që listat e pritjes për radioterapi të eliminohej deri

në muajin shtator, ngaqë deri tani është punuar me vetëm një aparat për rrezatim. Ai ka theksuar se investimet në këtë klinikë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për pacientët që kërkojnë shërbime në këtë klinikë. Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, ka pohuar se pas këtij investimi pacientët do të kenë mundësi që shërbimet në radioterapi t'i kryejnë në kohë më të shpejtë.

Vendoset pllakë falënderuese në shtëpinë e Isak Paçarizit që ishte në shërbim të UÇK-së

RAHOVEC, 22 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në vendosjen e pllakës falënderuese në shtëpinë e Isak Paçarizit që ishte në shërbim të UÇK-së. "Në Dragobil të Malishevës, në shtëpinë e bacës Isak Paçarizi, e cila gjatë vitit 1998 ishte vënë në shërbim të UÇK-së dhe shërbente si bazë e batalionit të Rahovecit, komanduar nga Xhelal Hajda-Toni, sot në përvjetorin e 23-të të kujtimit të

Epopesë së Rahovecit dhe nderimit të të rënëve për liri, së bashku me bashkëpunëtorë, bashkëluftëtarë e miq, nderuam sakrificën për liri, shpalesëm dëshmi të kujtesës historike përmes një pllake modeste të mermerit që do të shërbejë si dëshmi e përjetshme të historisë sonë më të re. Kjo pllakë mermeri është edhe një dëshmi që tregon për rolin dhe kontributin e madh të familjeve që shtëpitë e tyre dhe gjithçka patën i vunë në

shërbim të luftës për liri e të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë kryetari Latifi. Ai ka thënë se duhet të jemi krenarë me të kaluarën tonë. "Do të vazhdojmë pa u ndalur, edhe në këtë mënyrë me institucionalizimin dhe shënjimimin e vlerave tona kombëtare dhe historike. Mirënjohje dhe vlerësim përjetë për familjet që i kthyen shtëpitë e tyre në baza të të luftës së UÇK-së", ka thënë Latifi.



Komuna e Malishevës përkrah edhe 60 bujq me makina spërkatëse

MALISHEVË, 22 KORRIK (ER) - Në kuadër të përkrahjes për bujqit, komuna e Malishevës i ka shpërndarë edhe 60 spërkatëse 400 litërshe për 60 bujq. Ky subvencion është në kuadër të shpalljes publike të Drejtorisë për Bujqësi dhe Blegtori për subvencionimin e fermerëve

dhe, krahas shpërndarjeve të mekanizimit tjetër bujqësor, janë shpërndarë edhe këto spërkatëse montuese 400-litërshe. Sipas drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, ky projekt i subvencionimit të bujqve është rreth 33 mijë euro,

ndërsa përfitues janë 60 bujq të cilët kanë participuar me 30 për qind të shumës, ndërsa komuna me 70 për qind. "Ky nuk është projekti i fundit, por është në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme në sektorin e bujqësisë për bujqit e komunës sonë, pasi paraprakisht kemi

shpërndarë motokultivatorë, tani spërkatëse montuese 400 litërshe, më pas edhe makina mjelëse dhe shpërndarëse të plehut kimik", ka thënë drejtori Hoxha dhe, sipas tij, edhe këtë vit, sikur çdo vit tjetër, drejtoria planifikon përkrahje të vazhdueshme për bujqit.



Krasniqi takon Kosnetin: Bashkërendimi me Uashingtonin është vital dhe i pazëvendësueshëm

Prishtinë, 22 korrik (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett. Ai ka thënë se lidhja ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e shenjtë dhe e pathyeshme.

Në takim me ambasadorin Philip Kosnett, Krasniqi ka theksuar se PDK-ja si në pozitë ashtu edhe në opozitë, gjithmonë ka investuar në forcimin e raporteve mes vendeve dhe popujve tanë dhe kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Për PDK-në, bashkërendimi me Uashingtonin për çështje të interesit strategjik është vital

dhe i pazëvendësueshëm. Ambasadorin Kosnett e njoftova se PDK-ja si lidere opozitare do të angazhohet me kompetencë dhe profesionalizëm që të ofrojë alternativë kredibile për qytetarët e Kosovës", ka thënë Krasniqi pas takimit. Krasniqi në këtë takim ishte i shoqëruar edhe nga Vlora Çitaku.



Kuvendi e miraton marrëveshjen IPA për vitin 2020, përkrahjet edhe nga opozita

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 KORRIK - Me 89 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten marrëveshjen financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Këtë projektligj e ka paraqitur para deputetëve zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i cili ka theksuar se demokracia dhe qeverisja, mjedisi dhe sundimi i ligjit janë vetëm disa nga sektorët që do t'i mbulojë kjo marrëveshje. "Është kjo marrëveshje e fundit për

periudhën 2014/2020 dhe pas kësaj qeveria do të punojë me BE-në në kuadër të IPA-s për periudhën 2021/2027. Fondet e kësaj marrëveshjeje janë për rimëkëmbjen ekonomike, një pjesë e cilës është ratifikuar në Kuvend. Marrëveshja financiare për IPA 2020 është përfunduar vitin e kaluar. Sektorët që mbulon marrëveshja janë demokracia dhe qeverisja, luftimi i pasojave të pandemisë, asistencë për qasjen e Kosovës në Bashkimin Evropian, ndërsa sektori i sundimit të ligjit kap vlerën e 10 milionë eurove", ka thënë Bislimi.

Ndërsa kryetarja e Komisionit për

Integrim Evropian, Rezarta Krasniqi, ka thënë se marrëveshja ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e sektorëve si të demokracisë, mjedisit, arsimit e zhvillimit rural. "Marrëveshja financiare ka për qëllim zbatimin e asistencës nga BE-ja. Kjo marrëveshje ka rëndësi të veçantë që lejon zhvillimin e sektorëve të demokracisë, mjedisit e zhvillimit rural", ka thënë ajo.

Deputetja e LV-së, Arbreshë Kyreziu, ka thënë se Kosova nga kjo marrëveshje do të fitojë 90.2 milionë euro. "Kosova nga kjo marrëveshje do të fitojë 90.2 milionë. Pjesa më e madhe IPA 2

është negociuar nga qeveria Kurti 1. Pjesa më e madhe e fondeve do të drejtohen për çështjen e mjedisit dhe ato klimatike", ka thënë ajo.

Deputetja e PDK-ë, Blerta Deliu-Kodra, ka theksuar se, pavarësisht prej dallimeve, PDK-ja do ta mbështesë këtë marrëveshje ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Deputetja e LDK-së, Marigona Geci, ia ka kujtuar LV-së kohën kur nuk i votonte marrëveshjet ndërkombëtare. "Marrëveshjet ndërkombëtare nuk janë të pozitës dhe as të pozitës. LV-ja dikur nuk i ka mbështetur këto marrëveshje. Pavarësisht që ju nuk

i keni votuar, ne nuk duhet të veprojmë njëjtë si ju", është shprehur Geci.

Edhe AAK-ja e ka mbështetur marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Shefi i grupit parlamentar i këtij subjekti politik, Besnik Tahiri, ka drejtuar kritika ndaj qeverisë karshi agjendës së integritimit evropian. "AAK-ja do të mbështetë këtë marrëveshje, sepse ka një rëndësi të veçantë që prek jo vetëm aspektet me ekonominë, mirëpo edhe sektorë të tjerë. Si qeveri jeni me aktivitetin më të dobët sa i përket agjendës së integritimit evropian", ka deklaruar Tahiri.

Nga e diela rriten temperaturat mbi 30 gradë celsius

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar për parashikimin e motit për dy ditët e ardhshme. Sipas IHK-së, do të mbajë mot kryesisht i ngjashëm me rritje të lehta të

temperaturave maksimale. "Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 12-15 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 26-29 gradë celsius. Indeksi UV mbetet i lartë, andaj

këshillat e IKShP-së mbeten në fuqi që nga ora 10-16 mundësisht t'i kufizohemi rrezeve të diellit, ose të përdorim masa mbrojtëse. Do të fryjë erë kryesisht nga juglindja me shpejtësi 1-9m/s", ka njoftuar

IHK-ja.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka bërë me dije se nga dita e diel e tutje parashihen rritje të temperaturave maksimale mbi 30 gradë celsius.



Miratohet në parim Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 74 vota për kanë miratuar të enjten në parim Projektligjin për shitjen e

banesave për të cilat ekziston e drejta banesore. Qëllimi i këtij Projektligji u tha se është zgjatja e afatit për shitjen e banesave dhe blerja e tyre me

kushte të njëjta siç janë procedurat në ligjin bazik. Ndërkohë, u përkrah edhe nga partitë opozitare. Ministri i Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se me miratimin e këtij projektligji do të përfitojnë qytetarët.



Nuk ka burg për ata që nuk e deklarojnë pasurinë



PRISHTINË, 22 KORRIK - Mosdeklarimi i pasurisë nga zyrtarët shtetërorë në Kosovë, sipas Kodit Penal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Derisa deklarimi i rremë i pasurisë është i dënueshëm me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Mirëpo, për një çështje të tillë, asnjë nga zyrtarët që nuk e kanë deklaruar pasurinë nuk janë dënuar me burg. Madje edhe në rastet kur ndodh të shqiptohet dënim me burg, i njëjti me pëlqim të palëve, shndërrohet në dënim me gjobë. Sipas Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), dënimet, sa i përket mosdeklarimit dhe deklarimit të rremë të pasurisë, janë shumë të ulëta.

Leotrim Gashi nga ky institut ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se po të kishin qenë dënimet më të ashpra atëherë do të kishte më pak zyrtarë të cilët nuk do ta deklarorin pasurinë. "Pavarësisht që një zyrtar nuk e bën deklarimin e pasurisë, ata marrin dënime minimale, qoftë dënime me kusht ose dënime me gjobë, mirëpo nuk kemi parë që një zyrtar publik që e nuk ka deklaruar pasurinë, t'i shqiptohet një dënim me burgim", ka thënë Gashi. Sipas tij, duhet të ketë hetime më të thella lidhur me deklarimin e rremë të pasurisë. "Si AKK-ja, ashtu edhe prokuroria dhe policia, duhet të jenë më seriozë për hetim të rasteve për deklarim të rrejshëm të pasurisë dhe, po ashtu, edhe

gjykata në rastet kur vërtetohet se zyrtarët me dashje nuk kanë bërë deklarimin e pasurisë, atëherë ndaj tyre të shqiptohen dënime më të larta", ka deklaruar Gashi. Sipas IKD-së, shumica e rasteve të mosdeklarimit ose deklarimit të rremë dënohen me kusht ose me gjobë në vlerë prej 300 eurosh.

AKK: Mbi 100 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit

Rreth 5 000 zyrtarë shtetërorë në Kosovë kanë pasur obligim që ta deklarorin pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Në afatin prej 30-ditësh, nga data 1 mars deri më 31 mars,

mbi 100 prej këtyre zyrtarëve nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" Agron Behrami, shef i Divizionit për Deklarim të Pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Sipas tij, vitin e kaluar dhe këtë vit procesi i deklarimit të pasurisë ka qenë më i vështirë si pasojë e pandemisë, pasi pranimi i palëve ka qenë i ndaluar dhe të gjitha komunikimet janë bërë online. "Në mesin e këtyre zyrtarëve, 4 783 zyrtarë publikë kanë përmbushur obligimin ligjor brenda afatit ligjor dhe kanë dorëzuar formularët e tyre, ndërsa pas afatit e kanë deklaruar pasurinë 56 zyrtarë të lartë publikë. Njëzet e pesë nuk e

kanë deklaruar fare dhe 28 prej tyre për arsye shëndetësore dhe arsye të tjera nuk kanë mundur ta deklarorin", ka thënë Behrami. Behrami tha se për të gjitha rastet që nuk i respektojnë afatet për deklarim të pasurisë, agjencia ngrit kallëzime penale. "Të gjitha këto raste, në përjashtim të rasteve kur kanë arsye bindëse për agjencinë, të gjitha rastet e tjera do t'i procedojmë për kallëzime penale. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim dhe jemi duke i proceduar këto raste", ka deklaruar Behrami. Ligji për Deklarimin e Pasurisë obligon zyrtarët e lartë publikë që ta deklarorin pasurinë e tyre 30 ditë nga marrja e postit të ri dhe pastaj çdo vit.

Kuvendi voton Projektligjin për Infrastrukturën e Informacionit Hapësinor

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Kuvendi i Kosovës në seancën e së enjtes ka miratuar në parim Projektligjin për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit

Hapësinor. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se të dhënat hapësinore janë të domosdoshme për vendin.

Duke sqaruar këtë projektligj, ai ka thënë se të gjitha të dhënat hapësinore do të vendosen në një data bazë të vetme gjeohapësinore, e cila, siç tha Aliu, do të jetë e

qasshme edhe për publikun dhe institucionet qendrore e lokale. Projektligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor u mbështet me 68 vota.



Magjitë e veçanta të Donkishotit



Nga: Jorge Luis BORGES
Përkthet: Bajram KARABOLLI

Ka të ngjarë që këto vëzhgime të kenë qenë parashtruar ndonjëherë e ndoshta shumë herë; diskutimi i së resë në të më intereson më pak se e vërteta e saj e mundshme.

Krahasuar me librat e tjerë klasikë (Iliada, Eneida, Farsalia, Komedia danteske, tragjeditë dhe komeditë e Shekspirin), Donkishoti është realist; megjithatë, ky realizëm ndryshon thelbësisht nga ai që ushtroi shekulli XIX.

Zhozef Konradi ka shkruar se e përjashtonte nga vepra e tij të jashtëzakonshmen, sepse, ta pranojë atë, do të thoshte të mohojë që e zakonshmja ishte e mrekullueshme: nuk e di nëse Migel Servantesi e pati këtë perceptim, por di se forma e Donkishotit e bëri atë që botës imagjinare poetike t'i kundërvinte një botë reale prozaikë. Konradi dhe Henri Xhejmsi e romanizuan realitetin, sepse e gjykonin si poetik; për Servantesin realia dhe poetikja janë antinomi. Gjeografitë e djerra dhe të gjera të Amadisit (1) bien ndesh me rrugët plot pluhur dhe hanet varfanjake të Kastijas; imagjinojmë një romancier të kohëve tona që, me kuptim parodik, vë në dukje pikat e furnizimit me karburant; Servantes ka krijuar për ne poezinë e Spanjës së shekullit XVII, por as ai shekull e as ajo Spanjë nuk ishin poetike për të; njerëz si Unamunoja (2) apo Azorini (3) ose

Antonio (4) Maçadoja (5), të prekur para ringjalljes së Mançës, do të kishin qenë të pakuptueshëm për të. Plani i veprës së tij ia ndalonte mrekullinë; megjithatë ajo duhet të shfaqet, të paktën në mënyrë të tërthortë, ashtu si krimet dhe misterit në një parodi të romanit policor. Servantesi nuk mund t'u drejtohej talismanëve apo magjive, por e lë të kuptohet të jashtëzakonshmen në mënyrë të hollë, e cila, pikërisht për këtë, është më e efektshme. Thellë-thellë, Servantesi e dashuronte të jashtëzakonshmen. Pol Grusaku, më 1924, vuri re: "Me ndonjë ngjyrim latin apo italian të vendosur keq, prodhimi letrar i Servantesit, mbi të gjitha, buronte nga romanet bukolike dhe ata të kalorësisë, fabula gugatëse të robërisë." Donkishoti është më pak antidot i atyre fiksioneve sesa një lamtumirë sekrete nostalgjike. Në të vërtetë, çdo roman është një plan ideal; Servantesi kënaqet duke trazuar objektiven me subjektiven, botën e lexuesit me botën e librit. Në ata kapituj ku diskutohet nëse legeni i berberit është një përkrenare apo nëse samari është shalë, çështja shtrohet në mënyrë të qartë; siç e kam theksuar, e lë të kuptohet. Në kapitullin e gjashtë të pjesës së parë, prifti dhe berberi kontrollojnë bibliotekën e Donkishotit; çuditërisht, një nga librat e hulumtuara është Galatea e Servantesit, dhe rezultoni se berberi na qenkësh miku i tij, por nuk e admironte aq shumë; thotë

se ai na paskësh qenë më i zoti në të keqe se në vargje dhe se libri paskësh diçka prej sajese të mirë, thotë diçka, por nuk bën asgjë. Berberi, ëndrra e Servantesit apo forma e një ëndrre të Servantesit, gjykon Servantesin... Po ashtu, në fillim të kapitullit të nëntë, e habitshme është kur merr vesh se i tërë romani qenkësh përkthyer nga arabishtja, se Servantesi e paskësh blerë dorëshkrimin në tregun e Toledos dhe ia paskësh përkthyer një morisko (6), i cili paskësh bujtur në shtëpinë e Servantesit më shumë se një muaj e gjysmë, ndërkohë që kryente detyrën. Na shkon mendja te Carlyle i cili pohoi se goja vepra e tij Sartor resartus ishte version i pjesshëm i një veprë të publikuar në Gjermani nga doktor Diogjen Teufelsdröckh; po ashtu, na vjen ndër mend rabini nga Kastija, Moisiu i Leonit, i cili shkroi Zaharin apo Librin e Madhësisë dhe e popullarizoi si veprën e një rabini palestinez të shekullit III. Loja e dykuptimësive të çuditshme kulmon në pjesën e dytë; protagonistët kanë lexuar të parën, protagonistët e Donkishotit janë gjithashtu lexuesit e Donkishotit. Këtu është e pashmangshme të kujtosh rastin e Shekspirin, i cili në skenën e tragjedisë Hamleti përfshin një tjetër skenë, ku paraqitet një tragjedi e cila është pak a shumë ajo e Hamletit; përkimi jo i përkryer i veprës kryesore me dytësoren zvogëlon efektshmërinë e kësaj përfshirjeje. Një artific analoge si e Servantesit, madje edhe më e

habitshme, figuron te Ramayana, poema e Valmikit (7), që rrëfen bëmat e Ramës dhe betejën e tij me demonët. Në librin përfundimtar, bijtë e Ramës, të cilët nuk dinë se kush është babai i tyre, shkojnë për t'u fshehur në një pyll, ku një asket i mëson të lexojnë. Ky mësues, për habi, është vetë Valmiki, ndërsa libri që studiojnë është Ramayana. Rama porositi një flijim kuajsh; në atë krenim shkon edhe Valmiki me nxënësit e tij. Ata, me lahutat e tyre, këndojnë Ramayanën. Rama dëgjon historinë e tij, një të bijtë dhe pastaj shpërblen poetin...

Diçka të ngjashme ka sajuar fati edhe te Një mijë e një net. Ky ndërlikim historik fantastikë dyfishon e ridyfishon deri në marramendje degëzimin e një tregimi qendror në tregime të rastit, por nuk rreh të ruaj realitetin e tyre dhe efekti (që duhet të ishte i thellë) është sipërfaqësor, si një sixhade perse. Është e njohur historia e fillimit të serisë: betimi pikëllues i mbretit, që çdo natë martohet me një vajzë të virgjër, së cilës në agim i pret kokën, dhe zgjidhja që bën Shehrazade duke e zbavitur me përralla derisa mbi ta kalojnë një mijë e një net dhe ajo lind djalin e tyre. Nevoja për të mbushur një mijë e një net i ka shtyrë kopistët e veprës në ndërkallje të shumëllojshme. Veç asnjë nuk është aq trazuese sa nata DCII (602), më magjikja midis gjithë netëve. Atë natë, mbreti dëgjon nga goja e mbretëreshës historinë e tij. Dëgjon fillimin e historisë që përfshin gjithë të tjerat e gjithashtu – në mënyrë të llahtarshme – edhe

atë vetë. A e nuhat qartësisht lexuesi mundësinë e gjerë të asaj ndërkalljeje, të atij rreziku të çuditshëm? Se mbretëresha këmbëngul dhe mbreti, i shtangur, do t'i dëgjojë përgjithmonë historinë e cunguar të Një mijë e një netëve, tashmë të pafund dhe qarkore... Sajesat e filozofisë nuk janë më pak fantastike se ato të artit: Josiah Royce, në vëllimin e parë të veprës The world and the individual (1899), shprehet kështu: «Le të imagjinojmë se një pjesë toke e Anglisë është e niveluar përsosmërisht dhe se në të një hartograf vizaton një hartë të Anglisë. Vepra është e përsosur; nuk ka detaj nga toka e Anglisë, sado i vogël qoftë, që të mos jetë regjistruar në atë hartë; në të përkon gjithçka. Në këtë rast, kjo hartë duhet të përmbajë një hartë të hartës, e cila duhet të përmbajë një hartë të hartës së hartës, e kështu pafundësisht.»

Pse çuditëmi që harta qenka e përfshirë në hartë dhe një mijë e një netët në librin Një mijë e një net? Pse habitemi që Donkishoti qenka lexues i Donkishotit dhe Hamleti spektator i Hamletit? Besoj se e kam zbuluar shkakun: shndërrime të tilla sugjerojnë që, nëse personazhet e një fikcioni mund të jenë lexues apo spektatorë, atëherë edhe ne mund të jemi të trilluar. Në vitin 1833, Carlyle arriti në përfundimin se historia universale është një libër i shenjtë, i pambarimtë, që e shkruajnë, lexojnë dhe përipiqen ta kuptojnë të gjithë njerëzit, ku edhe ata vetë shkruhen.



INTERVISTË ME POETIN DHE PROFESORIN E LETËRSISË SHQIPE, SALI BASHOTA

Fillimet e secilit krijues të ri në Kosovë nisin me poezinë

Bisedoi: Berat
ARMAGEDONI

Na shkruani dhjetë rreshta vlerësim për një vepër të një autori shqiptar që keni lexuar gjatë kohës së karantinimit.

Për një kohë të gjatë jam marrë me leximin veprave të Mid'hat Frashërit, përkatësisht me serinë e botimeve *Vepra të zgjedhura (1-5)*, botuar nga Instituti i Studimeve Historike Lumo Skendo, ku përfshihen publicistika, dokumentet, letërkëmbimet, kujtimet, kritika letrare, proza letrare e botuar dhe krijimtaria letrare e panjohur deri më tani etj.

Po i jap dhjetë rreshta vlerësim ashtu siç e keni parashtruar pyetjen:

Shëmbëlltyra e Mit'hat Frashërit i ka shenjat më të përveçme të njërit nga personalitetet kryesore të shqiptarëve në të gjitha periudhat e zhvillimit të historisë. Jeta dhe vepra e tij e lartësojnë atdhetarin, intelektualin, artistin, diplomatin, i cili shquhej për dijen, kulturën, edukimin erudicionin e pakrahasueshëm me personalitetet e tjera të shqiptarëve, pothuajse në të gjitha periudhat e kohës.

Nga jeta e tij mësojmë çka është liria, atdheu dhe pavarësia, pastaj çka është: frymëzimi, përkushtimi,

guximi, vullneti, mundimi, dashuria, sakrifica, besimi, shpresa, durimi, ndërgjegjësimi, pasuria, të cilat evidentohen edhe në testamentin e Mid'hat Frashërit, ndërsa nga vepra e tij mësojmë për vlerat e identitetit, qytetërimit, kulturës, historisë, letërsisë, gjuhës, shkencës. Këtu do të përjetësohej madhështia.

Në një kumtesë, lidhur me raportin e poezisë me shoqërinë, keni paraqitur mendime shumë interesante. A do të shtonit diçka më tepër lidhur me këtë çështje?

Nëse më lejohet, në vend të ndonjë përgjigje tjetër, do t'i përsëritja ato mendime që i kam shprehur para pesë vjetësh. Përsëritja nuk është vetëm figurë e shqiptimit poetik, por diçka edhe më shumë.

Poezitë e bukura për shiun, për lulet, për zjarrin, për dashurinë, për vetminë, për lirinë, për atdheun etj. i kapin shenjat e tyre të veçanta për të prodhuar efekte estetike dhe ndjeshmëri, kryesisht përmes gjuhës, figurave, stilit. Secila prej këtyre poezive e ka përmbajtjen dhe domethënien e vet, të cilat i referohen lexuesit, për t'i dalluar apo pëlqyer të mirën, të keqen, të bukurën, të shëmtuarën etj.

Poezia gjithmonë e ka ndjenjën e pavarësisë nga artet e tjera. Kjo ndjenjë mund të shpërblehet me

pasionin e poetit për ta ndërtuar konceptin e botës së saj për shoqërinë dhe njerëzimin në përgjithësi. Shoqëria pa lexues të poezisë do të dukej shoqëri e vdekur përbrenda një imazhi të shkretëtirës. Në fakt, *Poezia nuk mësohet. Ajo ndihet*- thoshte Borhesi. Kjo thënie mund ta përmbysë çdo teori të interpretimit të poezisë.

Duke u nisur nga një model i ngjashëm, secili poet mund t'i mbledhë kujtimet dhe mendimet e përzgjedhura brenda kujtesës së tij për ta prodhuar imazhin e caktuar nga vullneti krijues, pra për të shkruar një poezi e cila nuk do të mësohej, por do ta kishte ndjenjën e përjetimit nga të tjerët. Pastaj, lexuesi do të kuptonte se çfarë është metafora e dritës dhe e errësirës, e ëndrrës dhe e zhgënjendrrës, e natës dhe e ditës, e dhembjes dhe e lumturisë etj., nëse ajo poezi do të kishte misionin e ndikimit në jetën njerëzore, me idetë, përmbajtjen dhe porosinë e saj.

Për më tepër, kujtesa dhe imagjinata sikur do të konceptoheshin me velin e figurave të bukura për ta ndërtuar fillin e frymëzimit, se si lindin ndjenjat, nga burojnë ato apo se si gdhenden fjalët më të zgjedhura për ta paraqitur një fakt, kësaj radhe, faktin estetik, i cili ndërliqhet me fjalën e shkruar, bashkë me

imazhet më të fuqishme që e ndërtojnë botën e poezisë.

Prandaj, poezia, kjo mbretëreshë e arteve, e ka klithmën e vet të pakrahasueshme, për t'i shprehur ndjenjat, shqetësimet, gëzimet, lumturinë, pikëllimin, dhembjen, dashurinë etj., duke e saktësuar kënaqësinë e ndjesive dhe të përjetimit estetik, në radhë të parë, brenda ligjëritimit dhe figurës për ta përcaktuar vizionin e një bote krijuese, e cila mund të bëhet pikë referimi për një shtresë lexuesish apo për një pjesë të caktuar të shoqërisë njerëzore të cilët e lexojnë, e çmojnë dhe e duan.

Nëse mund ta përcaktojmë rolin dhe misionin e poezisë, atëherë mund të krijojmë edhe përfytyrime e shpërfytyrime mendimesh të ndryshme që kanë të bëjnë me një lloj 'dyluftimi' midis imagjinatës dhe realitetit, për ta favorizuar komponentin e përjetimit të asaj që nuk mësohet, por përjetohet, siç është poezia. Fjala vjen, lëvizja e figurave përbrenda një poezie moderne, nëse do t'i përdorim në kuptimin figurativ e simbolik, siç janë: Toka, Qielli, Uji, Zjarri etj., do të mund ta ndërtonin botën e imazhit të veçantë për krijuesin, i cili e hulumton lëvizjen e shpirtit drejt përsosmërisë së gjyqimeve të tij. Dallimet, ngjashmëritë, faktet, idetë, dëshmojnë për perceptimin e një realiteti të rikthyer në figurë.

Sidoqoftë, labirintet e një kërkimi të tillë e krijojnë gjuhën e vet, pra gjuhën e poezisë.

I denë e fuqisë së poezisë së çdo gjuhe dhe etnie e krijojnë poetët, duke e përcaktuar ndikimin e saj në shoqëri. Poezia shqipe më së miri e ka provuar se ndikimi i saj në proceset e zhvillimit të shoqërisë shqiptare ka pasur një prani të jashtëzakonshme, sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Mesazhi i kësaj poezie është bërë program kulturor e kombëtar për identitetin e një letërsie, siç është letërsia shqipe, por edhe program edukimi.

Në shekullin XXI roli dhe ndikimi i poezisë në shoqëri nuk mund të krahasohet me periudhat e caktuara historike. Sot poezia e fuqizon misionin e saj për një shtresë të caktuar lexuesish. Rënia e popullaritetit të saj në shumë vende të botës i ka dhënë mundësi më shumë prozës, si dhe llojeve dhe formave të tjera të letërsisë. Megjithatë, poezia mbetet arti më elitist, i cili e mishëron sistemin e vlerave njerëzore të qytetërimeve të ndryshme. Madje, siç do të thoshte Oktavio Paz, *që prej epokës paleolitike, poezia ka qenë në simbiozë me të gjitha shoqëritë njerëzore. Nuk ka ekzistuar shoqëri që të mos ketë njohur njërën ose tjetrën formë të poezisë.*

Vizioni ynë për botën mund të perceptohet, madje edhe të

ndryshojë përmes poezisë. Shumë poetë të njohur botërorë kanë krijuar vepra të bukura poetike brenda të cilave qarkullojnë idetë për të ardhmen e shoqërisë së njerëzimit. Kështu, shikuar nga ky aspekt, roli i poezisë në shoqëri mund të trajtohet në shumë rrafsh të interpretimit.

Kur i lexon veprat e Homerit, Dantes, Brehit, Lorkës, Bodlerit, Eliotit, Borhesit etj., të cilët u përkasin letërsisë botërore apo veprat e Pjetër Budit, Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Lasgush Poradecit, që i përkasin letërsisë shqipe, lexuesi mund ta kuptojë dijen dhe shijen e secilës vepër poetike, për ta dalluar rolin e poezisë së këtyre poetëve jo vetëm për letërsinë e secilit komb, por edhe më gjerë.

Një poezi e shkruar në lashtësi, në mesjetë, në bashkëkohësi i ka veçantitë e saj, e ka kohën dhe hapësirën e vet, idetë, konceptet, temën, përmbajtjen, motivet për të krijuar një pikëpamje apo botëkuptim për njeriun dhe shoqërinë. Fjala vjen, një poezi e shkruar para një shekulli me fuqinë e saj shprehëse do të ishte aktuale edhe sot, pikërisht me mesazhet e saj për proceset e shoqërisë njerëzore.

Diversiteti i kulturave nuk e njeh diversitetin e poezisë. Poezia krijohet bashkë me universalitetin e kulturave, të identiteteve, të gjuhëve. Poezia e ka botën e vet. Bota e saj është imagjinata. Përmes ligjërimit të veçantë poetik ndërtohen gjuha, ritmi, figurat, fjalori poetik, të cilat bëhen dokument shpirtëror i jetës njerëzore.

Koncepti i ndikimit të poezisë në shoqërinë postmoderne është problematik dhe i diskutueshëm. Për t'i karakterizuar qëllimet dhe efektet e këtij ndikimi varen nga shumë faktorë letrarë dhe jashtëletrarë. Gjithashtu, edhe fryma e globalizmit në fundin e shekullit XX dhe në fillimet e shekullit XXI u nënshtrohet drejtpërdrejt vlerave të tjera të shoqërisë njerëzore në përgjithësi, si dhe specifikave të qytetërimeve të ndryshme, në radhë të parë, përbrenda botës së teknologjisë dhe të komunikimit. Megjithatë, mendoj se poezia edhe në ditët e sotme e ka ruajtur magjinë e saj të veçantë dhe gjithsesi është në epërsi të dyfishtë me llojet dhe zhanret e tjera, pikërisht për shkak të kodeve ligjërimore të saj dhe besimit të vazhdueshëm të lexuesit në kategoritë fundamentale estetike, të cilat dalin dhe burojnë nga shpirti i poezisë së vërtetë apo i poezisë së vlerave.

Një poezi e cila i shpalos idetë, vizionet, mendimet e njeriut, mund të bëhet pikë referimi për zhvillimin e ndërgjegjes njerëzore, prandaj shumë poetë përfaqësues të kulturave të mëdha dhe të vogla të qytetërimit botëror, pikërisht me poezitë e tyre kanë arritur t'i paraqesin idealet e kombeve të tyre. Kjo ka ndodhur në shekujt e kaluar, në periudhën e zhvillimit dhe të pavarësimit të identiteteve dhe kombeve.

Sot ndikimi i poezisë në shoqëri mund të vështrohet nga kompleksiteti i traditës së favorshme të saj dhe nga sfida e

postmodernizmit drejt teknologjive të reja të komunikimit. Natyrisht, kërkimet për ndikimin e poezisë në jetën shoqërore mund të varen nga shumë faktorë. Prandaj, faktori edukativ, kulturor, social, madje edhe faktori politik, secili prej tyre, e zë vendin e vet në rrethana të caktuara kohore.

Vlerësimet e sotme për rolin e poezisë në shoqëri mund të krijojnë bindje të ndryshme të bashkëlidhura shumë ngushtë me vetë pozicionin dhe misionin e poetit në një shoqëri me demokraci të zhvilluar, në një shoqëri më pak demokraci apo në një shoqëri tjetër pa demokraci.

Në këtë mënyrë do të hiqeshin apo do të shtoheshin dilemat se e ardhmja e poezisë pa rolin e saj në shoqëri, mund të ishte një mendim utopik, i cili do ta ndërtonte parabotën e vet drejt një misteri të çuditshëm dhe të panjohur. Prapë po e përsëris mendimin e Pazit, se *poezia ka qenë simbiozë me të gjitha shoqëritë njerëzore*, për ta dëshmuar fuqinë dhe ndikimin e saj në periudha të ndryshme të njerëzimit.

Si do ta mendonim sot artin e poezisë pa veprat monumentale të Homerit, Dantes, Hugoit, Gëtes, Pëtefit, Posë etj. të cilat kanë ndikuar dhe ende ndikojnë në zhvillimin e mendjes njerëzore? Kjo është çështja.

Cili është mendimi juaj për letërsinë e të rinjve dhe për botimet?

Letërsia shqipe në Kosovë i njeh brezat letrarë apo gjeneratat poetike. Botimi dhe afirmimi i vlerave të letërsisë shqipe në Kosovë kryesisht është projektuar përbrenda brezave letrarë, të cilët orientimisht janë përcaktuar përbrenda një dhjetëvjeçari. Kjo ka të bëjë me letërsinë në Kosovë, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Për shembull, brezi letrar i viteve gjashtëdhjetë, brezi letrar i viteve shtatëdhjetë, brezi letrar i viteve tetëdhjetë etj. Në kuadër të brezave letrarë janë afirmuar individualitetet kryesore letrare të cilët jo rrallë janë bërë projektues dhe bartës të prirjeve të ndryshme letrare, estetike dhe stilistike.

Në këtë drejtim, gjysma e dytë e shekullit XX shquhet për prirje dhe tendenca të reja tematike, figurative dhe stilistike të secilit brez, duke filluar nga dimensionet social e deri tek ironia lirike. Produkti i botuesit i realizuar nga Ndërmarrja Botuese *Rilindja*, sidomos në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit XX në Kosovë, ka krijuar një ambient dhe klimë kulturore për avancimin e vlerave letrare, për botimin dhe promovimin e tyre dhe, pa dyshim, pos rolit të veçantë kulturor, ka pasur edhe një mision të rëndësishëm edukativ.

Përveç Ndërmarrjes Botuese, gjithashtu gazeta e përditshme *Rilindja*, revista letrare *Jeta e re*, revista për kulturë, art dhe letërsi *Fjala*, si dhe gazeta të shumta javore e dyjavore, *Zëri i rinisë*, pastaj me emrin *Zëri, Bota e re, Shkëndija, Kosovarja* etj., kanë arritur të krijojnë një ambient kulturor në

Kosovë i cili më vonë u ka prirë shumë proceseve për ndryshimin e realitetit jetësor, social, madje edhe politik në Kosovë. Gjithsesi, është me rëndësi paraqitja e këtyre fakteve, për të kuptuar më qartë dhe më saktë kontinuitetin e kulturës dhe të letërsisë shqipe deri në vitet nëntëdhjetë, ku ndodhi aparteidi kulturor, arsimor e politik nga regjimi i Serbisë deri te pushtimi i institucioneve dhe përzënia e shqiptarëve nga vendet e punës. Në këtë rast, duhet thënë se roli i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës në vitet '90 të shekullit të kaluar pothuajse ka qenë vendimtar për shumë procese kombëtare, por edhe kulturore në Kosovë.

Nëse kultura është shpëtimi ynë i vetëm, siç thoshte Borhesi, atëherë nxitja, përkrahja dhe mbështetja e krijuesve të rinj duhet të jetë orientimi i një shoqërie që synon promovimin dhe zhvillimin e vlerave të saj identitare.

Autorët e rinj natyrisht se i kërkojnë temat e reja për t'i prodhuar frymëzimet e tyre letrare dhe estetike në vepra të caktuara, në lloje dhe zhanre të ndryshme. Ndryshimi i shoqërisë, proceset e reja demokratike, pavarësia e Kosovës, si dhe ambienti kulturor në këta dy dhjetëvjetëshat e fundit, ka përcaktuar një dinamikë tjetër në fushën e botimeve, por edhe në përkrahjen e letërsisë së të rinjve.

Në rrethana të tilla, padyshim, përkrahja institucionale sigurisht se do të krijonte një mundësi të rëndësishme për konsolidimin e gjeneratave të reja të cilat do të shqueshin në fusha të ndryshme të kulturës, të artit dhe shkencës. Në këtë mes, letërsia e të rinjve, kryesisht e përqendruar me botimin e veprave të tyre nga botues privatë, me gjithë përpjekjen e këtyre të fundit me fonde modeste, megjithatë nuk ka arritur ta gjejë rrugën e sigurt të suksesit të saj, prandaj janë shumë faktorë që ndikojnë jo vetëm në mospërkrahjen e kësaj letërsie.

Pothuajse, fillimet e secilit krijues të ri në Kosovë i përkasin poezisë. Kështu poezia mbetet shqetësimi kryesor i autorëve të rinj të cilët përpiqen t'i artikulojnë ndjenjat dhe mendimet e tyre, duke trajtuar tema të përditshmërisë, por edhe tema të tjera që ndërlidhen me frymëzimet dhe shqetësimet e tyre krijuese.

Botimi më i vogël i veprave me prozë (tregime, novela, romane), pastaj i veprave të rralla në fushën e kritikës, si dhe i veprave dramatike, dëshmon se interesimi i autorëve të rinj është përqendruar kryesisht në fushën e poezisë.

Një ndër çështjet më të rëndësishme që do të duhej diskutuar sot në debate të ndryshme, kur flitet e shkruhet për letërsinë dhe për botimet e veprave të autorëve, është pikërisht profesionalizmi po në këtë fushë, që ndërlidhet me punën e shtëpive botuese, në radhë të parë për kompetencat profesionale të disa mekanizmave vendimmarrës për botimin e librit të ri, siç janë: redaktori, recensenti dhe lektori, pastaj përgatitja teknike, shpërndarja, shitja, honorarët etj. Gjithsesi, në këtë drejtim nuk mjafton vetëm vullneti dhe përkushtimi. Dija dhe

profesionalizmi janë baza kryesore që një libër të botohet sipas kriterëve letrare.

Në anën tjetër qëndron roli dhe misioni i kritikës letrare. Mendimi kritik për librin, ishfaqur publikisht, pa paragjykimë, por vetëm me fakte dhe argumente kritike, është në interes të vlerësimit të krijimtarisë së autorit, por edhe të zhvillimit të letërsisë shqipe.

Mundësisht, na lini të shkruar këtu një këshillë për një poet të ri.

Nuk do të mund të përfytyrohej asnjë propozim që do të mund të bëhej detyrim i caktuar për një poet të ri. Megjithatë, këshillat për një poet të ri sigurisht janë të mirëserardhura dhe mund të ndikojnë në rrugëtimin e tij krijues. Për secilin poet shkrimi është një aventurë e qëllimshme krijuese, që nisat nga procesi i një leximi pasionues e të vëmendshëm, për ta prodhuar komunikimin individual me të tjerët përmes shkrimit që e prodhon vetë, pra që bëhet pasuri shpirtërore nëpërmjet ideve, motiveve, temave dhe përbërësve të tjerë.

Këshilla për poetin e ri është: vullnet, përkushtim dhe punë.

Cila është poezia dhe proza juaj poetike më e mirë? Ndajini dy.

Një provë e vështirë për secilin poet për ta përzgjedhur krijimin e vet më të mirë. Zgjedhja nuk i nënshtrohet gjithmonë horizontit tregues të parimeve të shpirtit, midis arsyes dhe ndjenjës apo, madje, edhe midis përfilljes dhe shpërfilljes. Mund të jetë ndikim i drejtpërdrejtë apo edhe i tërthortë i çastit. Një grindje jo e lehtë me vetveten. Përse e zgjedha këtë e jo atë tjetrën? Cili do të ishte gjykimi i shijes estetike të poetit për vetveten, kësaj radhe, në mesin e pothuajse një mijë krijimeve poetike (shtatëqind poezive e treqind prozave poetike), për t'i dalluar dy prej tyre. Sigurisht herën tjetër do të jepja një mendim ndryshe. Shembujt mund të jenë të shumtë. Megjithatë, po i dalloj dhe po i lavdëroj dy prej tyre: *Vjersha që po jepte shpirt* dhe *Liri me gjarpër në gjë*. E para, është botuar në librin *Dalje nga trishtimi* (1999), ndërsa e dyta në librin *Plagomë* (1994).

Përse kësaj radhe po i dalloj këto dy krijime poetike?

E kam të qartë se përgjigjja vjen vetvetiu nga çasti i përcaktimit të një ndjenje të miratuar, e cila buron nga brenda, sipas vetëdijes për vetë ekzistencën e krijimit poetik, ndoshta lidhja më emocionale. Kjo mund të jetë edhe fryma, por edhe pasioni im për saktësinë e kësaj përzgjedhjeje, sipas mënyrës sime.

Vjersha që po jepte shpirt është shkruar në vitin 1997. Ishte fundi i muajit shtator. Poezinë e shkrova me laps-kimik në një fletë të bardhë. Disa herë mendoja ta grisja, sepse më dukej se kishte shumë vargje elegjiake. Pastaj e radhita në makinën e shkrimit. Vajzat e mia më bënë lloj-lloj pyetjesh, thujse unë po bëhesha lakmitar i të gjitha përgjigjeve, ndoshta edhe për aftësinë e imagjinatës sime përbrenda filozofisë së ndjenjave.

Pothuajse të gjitha ma bënin

pyetjen tepër interesante: si jep shpirt poezia? U shtanga nga zgjuarsia e tyre, pastaj sikur u çlirova nga ankthi i frymëzimit dhe më dukej se fëmijët e mi po i imitonin ëndrrat e tyre, të përziera me ndjenjën e frikës dhe të dhimbjes, por edhe të dashurisë.

Tani mund të them se shenjat autobiografike, bashkë me kujtimet personale, dëshmojnë kohën dhe çastin që në pamjen e parë e poetizojnë çastin e dhimbshëm për zbërthimin e imazheve përmes ligjërimit mohues (*mos e gris, mos e djeg, mos e plagos, mos e përgjak, mos e varros*). Është një shkallëzim i situatave të përjetuara shpirtërore, midis shprehjes dhe komunikimit, të cilat e bartin mesazhin përmes aktantëve, në këtë rast, fëmijëve të mi: Albulena, Besiana, Doruntina, Etleva dhe Rozafa. Aty ka rikuptimësim, por edhe rikontekstualizim të asociacioneve, pikërisht përmes ndjenjës së fajit dhe ndjenjës së katarsisë, për ta fuqizuar hapësirën kuptimore me ringjalljen e formave ligjërimore dhe të formave gjuhësore. Ankthi, dhimbja, mëkati, shpëtimi dhe shpirti e krijojnë një sistem ligjërimit dhe figurativ, për ta shqiptuar përmasën e aktit të veprimit përbrenda përfytyrimit të situatave të zhgënjimit dhe të refuzimit, në të njëjtën kohë.

Përse vjersha po jepte shpirt?

A është ky kufiri i së vërtetës reale, i konceptuar përbrenda shumësisë së kuptimeve përmes thënies e kundërthënies drejt bërjes dhe shpërbërjes së një ideje poetike, kur hamendja e sprovonte nxitjen e një veprimi, për të arritur në pikën përfundimtare: *vjersha që po jepte shpirt*.


Më kujtohet mirë se si ishte mbërthyer në kujtesën time kjo poezi, si dëshmi fantastike që më tërheq edhe sot për ndjesinë e përjetimit të një çasti dashuror, pikërisht në stinën e vjeshtës, në stinën e krijimtarisë sime poetike.

Pothem edhe disa mendime për krijimin e dytë që e zgjedha. Pra, proza poetike e rimuar, *Liri me gjarpër në gjë*, e shenjëzon kodin ligjërimit përmes shprehjeve konceptuale të ndërlidhura me realitetin dhe me sfondin mitologjik. Është një skemë e përmbyesjes së kuptimeve brenda një trinie: *liria, gjarpri, gjiri*. Njohja e realitetit është përjetim, pikërisht brenda çastit të ligjërimit, aty ku kemi prani, por edhe mungesë të lirisë.

Liri me gjarpër në gjë është strukturuar si poetikë e dhimbjes në robëri. Bërthama e kësaj proze poetike është liria. Kjo prozë poetike është e rëndësishme për mua, meqë isha dëshmitar i ngjarjeve të rënda që ndodhnin në atë periudhë për popullin tim. Në fakt, ishte një dhunë me sulme të vazhdueshme ndaj identitetit shqiptar, ndaj gjuhës, kulturës, historisë, që bëhej nga regjimi i Serbisë, i instaluar në atë periudhë në Kosovë.

Sikur çdo ditë mendonim për udhëtimin drejt të panjohurës.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Vizion në numrat e ardhshëm të gazetës. © "Armagedoni").



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ekipi olimpik i xhudos mëson shortin në rrugën drejt medaljeve olimpike

“Shorti në Lojërat Olimpikë e ka rëndësinë e vet, por jo të madhe. Për ekipin tonë shorti është një nismë e rrugëtimit. Në xhiron e parë realisht garuesit tanë duhet të ecin tutje, e pastaj të shohim”, ka thënë Driton Kuka



Prishtinë, 22 korrik - Ekipi olimpik i xhudos të enjten ka mësuar shortin para garave që nisin të shtunën në Lojërat Olimpikë “Tokio 2020”. Të pesë garuesit e Kosovës me normë olimpikë, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Lorian Kuka dhe Akil Gjakova, synojnë medalje olimpikë. Trajneri Driton Kuka, që ka ndjekur online shortin për shkak të masave ndaj Covid-19, pret që garuesit e tij të vazhdojnë tutje edhe pas raundit të parë. “Shorti në Lojërat Olimpikë e ka rëndësinë e vet, por jo të madhe. Për ekipin tonë shorti është një nismë e rrugëtimit. Në xhiron e parë realisht garuesit tanë duhet të ecin tutje, e pastaj të shohim”, ka thënë Driton Kuka. Numri një në renditjen olimpikë, Distria Krasniqi, e cila garon të

shtunën, ka kaluar raundin e parë pa luftë, pasi është bartësja e parë e kategorisë deri në 48 kilogramë. Në raundin e dytë do të përballlet me fituesen e luftës mes Gabriela Chibana (Brazil) dhe Harriet Bonface (Malavi). Kampionia olimpikë, Majlinda Kelmendi, në raundin e parë do të takohet me hungarezen Reka Pupp, kategoria deri në 52 kg. Kelmendi është bartësja e katërt. Ajo garon më 25 korrik. Medalistja e bronzit e botës, bartësja e tretë e kategorisë deri në 57 kilogramë, Nora Gjakova, raundin e parë e kalon pa luftë, ndërsa në raundin e dytë pret fituesen e luftës mes Sabina Filzmoser (Austri) dhe Sanne Verhagen (Holandë). Nora garon më 26 korrik. Pa luftë në raundin e parë ka kaluar edhe medalistja

tjetër e bronzit e botës, Lorian Kuka, kategoria -78 kg. Ajo në luftën e dytë përballlet me fituesen e duelit mes Marie Branser (Kongo) dhe Aleksandra Babintseva (Rusi). Lorian garon më 29 korrik. Kampioni i Evropës, Akil Gjakova, në raundin e parë përballlet me Ahmed Ayash të Jemenit, ndërsa nëse kalon kundërshtarit e parë, në të dytën e pret Nils Stump i Zvicrës. Akili garon më 26 korrik. Para hedhjes së shortit, me nga një fjalë rasti janë drejtuar presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos si dhe drejtues tjerë të federatës dhe vendit mikpritës, ndërsa në prezantimin e kategorive nuk kanë munguar pamje të xhudistëve të Kosovës të cilët janë vlerësuar lart për potencialin që kanë.

SHKURT

Sot përurohet shtatorja e Fadil Vokrrit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka bërë me dije se të premten do të përurohet shtatorja e ikonës e futbollit shqiptar, Fadil Vokrrit. Përurimi do të bëhet në stadiumin që mban emrin e tij, në Prishtinë, nga ora 18:00. Ceremonia është planifikuar me datë 23, që shënon datëlindjen e tij, kur ai do të bëhej 61 vjeç. Ministria ka bërë me dije se në ceremoni pritet të jenë të pranishëm kryeministri Albin Kurti, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kryetari i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi si dhe personalitete të tjera të institucioneve dhe të sportit. Për nder të ceremonisë, FFK-ja ka organizuar një turne futbollit ku do të marrin pjesë futbollistët veteranë të Llapit, Prishtinës, Përfaqësueses së Kosovës dhe Kombëtares së Shqipërisë.

Bardhi, përforcimi i radhës nga Dukagjini

Futbollisti Argjend Bardhi është futbollisti më i ri i skuadrës së Dukagjinit nga Klina. Marrëveshja me ish-anëtarin e Feronikelit është zyrtarizuar sot nga Dukagjini në faqen zyrtare në “Facebook”. “Futbollisti Bardhi edhe zyrtarisht ka përforcuar Klubin e Dukagjinit. Argjendi është transferuar në Klinë nga Klubi i Feronikelit, ndërkohë më parë është aktivizuar edhe te Klubi i Drenicës. Bardhi luan në pozitën e mesfushorit qendror. I lindur më 28 prill 1995, njëzet e gjashtë vjeçari karrierën e futbollit e filloi në shkollën e Futbollit ‘Kurda’”, thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Enis Vila i bashkohet Kosovës U19

Futbollisti me prejardhje nga Kosova, Enis Vila, ka vendosur që t’i përfaqësojë ngjyrat e Kosovës. Mbrojtësi i skuadrës MSV Duisburg do të jetë pjesë e “dardanëve” U19. “Kryetari Agim Ademi priti në takim futbollistin Enis Vila me prejardhje nga Kosova i cili karrierën po e zhvillon në Gjermani. Qendërmbrojtësi i cili luan për skuadrën gjermane MSV Duisburg U19 u shpreh i lumtur për ftesën që ka marrë dhe shprehu gatishmërinë për t’iu bashkuar ‘dardanëve’. Me këtë vendim futbollisti Vila po realizon dëshirën e tij dhe të prindërve të tij për ta përfaqësuar Përfaqësuesen U19 të Kosovës. Enis Vila si qendërmbrojtës është mjaft perspektiv dhe për këtë ai po vëzhgohet nga klube të mëdha në Bundesliga”, thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Donjeta Sadiku përballlet me Caroline Dubois

PRISHTINË, 22 KORRIK - Është hedhur të enjten shorti për garat e boksit në Lojërat Olimpikë “Tokio 2020”. Boksierja e Kosovës, Donjeta Sadiku, do të përballlet me Caroline Dubois nga Britania

e Madhe në raundin e parë. 20-vjeçarja është kampione olimpikë për të reja, kampione e botës për të reja dhe katër herë kampione e Evropës për të reja. Ajo normën olimpikë e fitoi në

turneun olimpik të mbajtur në Londër dhe më pas në Paris. Trajneri i Sadikut, Besim Brahimi, që ishte i pranishëm në short, thotë se shorti ishte i pafat për boksieren e tij, por që ai ka besim se Donjeta do

t’ia dalë të kalojë pengesën e parë. Meçi do të zhvillohet më 27 korrik në Kokugikan Arena të Tokios dhe parashihet të fillojë në ora 6:24 me kohën tonë lokale dhe në 13:24 me kohën lokale të Japonisë.



Veton Kabashi rikthehet te Istogu

ISTOG, 22 GUSHT - Mbrojtësi Veton Kabashi është rikthyer në skuadrën e Istogut. Prezantimi i Kabashit do të bëhet të hënën kur edhe do të nënshkruajë kontratë njëvjeçare. Kabashi ishte kapiten dhe lider i skuadrës së

Flamurtarit për tetë vjet me radhë, ku ishte lojtari më i dalluar në fazën e mbrojtjes. “Të hënën do të paraqitet Veton Kabashi, lojtari më i ri i Istogut, ku edhe do të nënshkruajë kontratën njëvjeçare. Kabashi ishte

kapiten dhe lider i skuadrës së Flamurtarit për tetë vjet me radhë dhe ishte lojtari më i dalluar në fazën e mbrojtjes. Mbrojtësi Kabashi me përvojën e tij dhe me kualitetet e larta që i ka do t'i ndihmojë shumë skuadrës së Istogut drejt

arritjeve të objektivave në edicionin e ri 2021-2022! Vetoni ka vendosur që t'i refuzojë shumë skuadra të Superligës, vetëm që t'i bashkohet klubit të qytetit të tij, ku edhe i mësoi hapat e parë si futbollistë”, thuhet në njoftimin e Istogut.



KB Prizreni konfirmon pjesëmarrjen në Ligën Unike

PRIZREN, 22 KORRIK - KB Prizreni ka konfirmuar pjesëmarrjen në edicionin e ri të Ligës Unike. Skuadra prizrenase edicionin e kaluar në Superligën e Kosovës në basketboll përfundoi garat e rregullta në vendin e parë, kurse në gjysmëfinale të “Play-offit” ishte eliminuar nga Peja, duke fituar të drejtën për të marrë pjesë në Ligën Unike. Drejtuesit e klubit prizrenas, pas një takimi me drejtuesit e Ligës Unike, janë pajtuar për të marrë pjesë dhe duke u shprehur të lumtur që do të jenë pjesë e kësaj lige, që bashkon skuadrat nga Kosova dhe Shqipëria. Më herët, kampioni i Ligës Unike dhe Kosovës, Golden Eagle Ylli, ka konfirmuar pjesëmarrjen, ndërsa shumë shpejt do të bëhen të ditura të gjitha klubet të cilat do të garojnë në edicionin e ardhshëm të Ligës Unike. Risi në këtë edicion do të jetë



edhe fillimi i garës në konkurrencën e femrave, me tri skuadra nga Kosova dhe tri nga Shqipëria, derisa shorti për të dy konkurrencat do të hidhet në muajin gusht. Edicioni i ri

në Ligën Unike do të fillojë më 20/21 tetor, kurse para fillimit të garave do të organizohet Superkupa Mbarëkombëtare në të dyja konkurrencat.

Sportistja më e vjetër dhe më e re në Olimpiadë



TOKIO, 22 KORRIK - Në Lojërat Olimpikë “Tokio 2020” mund të garohet në çdo moshë nëse arrin të kualifikohesh. Personi më i vjetër në moshë në Olimpiadën japoneze që nis nesër është 66-vjeçarja australiane Hanna Mary e cila garon në sportin e hipizmit. Ndërsa sportistja më e vogël është 12-vjeçarja Hend Zaza që garon për

Sirinë në sportin e pingpongut. Gjyshja Hanna, siç njihet ndryshe 66-vjeçarja australiane, ka tre nipër dhe së shpejti pret edhe një të katërt. Ajo vjen nga një familje me tradita në sportin e hipizmit dhe arriti për herë të parë të jetë në një Olimpiadë. Ajo është sportistja më e vjetër që përfaqëson Australinë në historinë e Lojërave Olimpikë. Ndërsa sportistja

më e vogël është 12-vjeçarja siriane Hend Zaza e cila vjen nga qyteti Hama, tashmë i shkatërruar nga lufta civile në këtë vend. Me një raketë pingpongu në dorë ajo ka mposhtur frikën e bombave të luftës dhe përfaqëson shpresën në këtë Olimpiadë. Ajo ndjek një traditë të familjes, pasi edhe vëllai i saj merret me pingpong.

SHKURT

‘Tokio 2020’, numri i të infektuarve me Covid shkon në 91

Raste të tjera me Covid në Fshatin Olimpik të Tokios. Të premtën zhvillohet ceremonia e hapjes së Lojërave Olimpikë që do të zgjasin deri më 8 gusht. Varianti Delta po përhapet me shpejtësi dhe katër banorë të tjerë të Fshatit Olimpik Tokyo 2020, duke përfshirë dy atletë, rezultuan pozitivë me Covid-19. Që prej fillimit të korrikut, 91 persona të akredituar për Olimpiadën janë infektuar me koronavirus. Candy Jacobs (skejtboard) nga Holanda dhe Pavel Sirucek (ping pong) nga Republika Çeke rezultuan pozitivë dhe u larguan nga fshati për ta nisur karantinën në hotel.

Chelsea mendon rikthimin e Hazardit

Chelsea është gati të hidhet në merkato. Klubi londinez po konsideron rikthimin e yllit belg, Eden Hazard. Real Madridi nuk duket të jetë pengesë, pasi belgu nuk ka dhënë më të mirën e tij në “Santiago Bernabeu”, i kushtëzuar edhe nga dëmtimet sistematike. Për t'u liruar nga shërbimet e Hazardit, Real Madridi kërkon së paku 60 milionë euro. Në rast largimi nuk dihet se cili do të jetë zëvendësuesi i tij në Madrid, por këtë merkato madrilenët kanë pasur “rrjedhje” me largime si Sergio Ramos dhe Raphael Varane (për të cilin mungon vetëm zyrtarizimi te Manchester Unitedi).

PSG-ja vazhdon kontaktet me Koulibalyn

Kalidou Koulibaly është ende në orbitën e Paris Saint-Germainit. Sipas portalit francez “Foot mercato”, edhe pas marrjes së Sergio Ramosit klubi francez vazhdon kontaktet me përfaqësuesit e mbrojtësit senegalez, i cili ka edhe dy vjet të tjera në kontratë. Për trajnerin Luciano Spalletti është i paprekshëm, por presidenti De Laurentiis është i gatshëm ta shesë lojtarin nëse do të merrte një ofertë prej 60 milionë eurosh.

Buffoni rikthehet të luajë me Parmën pas 7339 ditësh

Portieri Gianluigi Buffon është rikthyer te Parma. Buffoni ka zhvilluar mbrëmë ndeshjen e parë me skuadrën e Parmës pas saktësisht 7 339 ditësh. Portieri është rikthyer te skuadra e tij ku u rrit pas 20 vjetësh dhe tani ka debutuar sërish në ndeshjen miqësore ndaj Bochumit. Italiani luajti vetëm në pjesën e parë të ndeshjes, duke arritur ta mbajë portën e paprekur, ndërsa në pjesën e dytë Bochumi fitoi me rezultat 1-0. 43-vjeçari duket ende në formë fantastike dhe nuk e ka ndërmend të tërhiqet nga futbollit, pasi ka kontratë me Parmën deri në qershor të vitit 2023. Kujtojmë që Parma sezonin e ardhshëm do të bëjë gara në Serinë B të Italisë.

Van Gaali pritet ta marrë drejtimin e Holandës

Pas largimit të Frank de Boerit në drejtimin e Holandës, kjo e fundit është në kërkim të një trajneri duke parë se në shtator fillojnë ndeshjet e kualifikuesve

të Botërorit “Katar 2022”. Sipas asaj që raportojnë mediat holandeze, anëtarët e këshillit të Federatës Holandeze të Futbollit kanë arritur pajtim për

një rikthim të mundshëm në bankinën e “tulipanëve” të Luis Van Gaal. Trajneri 69-vjeçar ndodhet pa asnjë ekip që në vitin 2016 pas largimit të tij nga

Manchester Unitedi dhe pritet të rikthehet në stolin e “portokallinjve” për të tretën herë, ku i stërviti në vitin 2000 dhe në vitin 2012. Van Gaali

herën e fundit ishte te kombëtarja holandeze nga viti 2012 deri në vitin 2014 nga ku drejtoi “tulipanët” për 29 ndeshje.



Kryetari i Komunës 01-nr.464- 4440 , Dt. 21.07.2021 - S u h a r e k ë

Ne bazë të nenit 4, nenit 10 te Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme Nr.03/L-139 dt. 26 mars 2009 të Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit mbi shpronësimin e Pronës së Palujtshme nr.03/L-205 dt. 10 dhjetor 2010, nenit 44 te Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative O/L-031, bazuar ne Vendimin Nr. 01 nr.465-016-12540, dt.19.02.2021 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit te komenteve dhe deklaratave te palëve, brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë :

VENDIM PRELIMINAR

(Për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

I. SHPRONËSOHET prona private e pronarve dhe zotruese të interesit, për interes publik për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike në Suharekë e cila gjindet në ngastrën kadastrale me nr.P-72116046-01453-30 ne sip prej: **24 m2** me kulturë arë në vendin e quajtur "Rezina", evidentuar në emër të Muharem (Shaban) Kuqi, ZK. Suharekë.

II. Vërtetohet se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim te arritjes e këtij qëllimi.

III. Zotruesi i interesit të pronës se cekur ne pikën 1. te këtij Vendimi do të kompenzohet konform dispozitave ne fuqi te Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme.

IV. Vendimin Preliminar, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit te tijë, Organi shpronësues do të ia dergon, zotëruesve te interesit te pronës dhe personave te tjerë te cilët pretendojnë se u takon ndonje e drejtë në pronën e shpronësuar, bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të këtijë Ligji.

V. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit te Vendimit Preliminar, Organi shpronësues e shpall Vendimin në një gazetë zyrtare me tirazh me të madhë në Kosovë, ndërsa ky vendim hynë në fuqi ditën e shpalljes në këtë Gazetë

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit te kerkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv te këtijë Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qellim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtat

private, se pjesa e pronës se palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji.

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të palujtshmerisë Nr. 01 nr.465-016-12540, dt.19.02.2021 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues-Drejtorisë për Shërbime Publike te Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tijë, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes ne fuqi te këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtuesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtuesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejtë të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkues

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës
Bali Muharemaj

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fidan Taç B.I. N.T.SH."F-Aresi" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 70623429 nr: Unik Identifikues 810893249 si dhe me nr: fiskal 600422422.
- Haki Juniku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH. M. Teknike të Tekstilit në Gjakovë.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

